

LIDHJA E PENSIONISTËVE DHE  
INVALIDËVE TË PUNËS TË  
REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
NR. 67 DT. 19.08 2014,  
PRISHTINË

AGJENCIONI I PAVARUR I RREGULLATORIT  
PËR ENERGJI TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
PRISHTINË

Lënda: Reagim ndaj Vendimit për Rritjen  
e çmimit të rrymës elektrike (5%).

Lidhja e Pensionistëve dhe invalidëve të Punës në Republikën e Kosovës, si asociacion i gjërë i këtij komuniteti dhe më gjërë (118000 + 38000 pensionistë) energjikisht reagojnë dhe kundërshtojnë Vendimin e ngritjes së çmimit të energjisë për 5% të miratuar nga Agjencioni i Juaj.

Zotërinjë të nderuar,

Duke u nisur nga gjendja e vështirë socio-ekonomike e pensionistëve dhe invalidëve, nga gjendja e pazgjedhur e pensioneve të merituar dhe definitivisht konstatimi se pensionistët në Republikën e Kosovës, i përkasin kontigjentit – të varfërisë dhe varfërisë së skajshme – atëhere mund të thuhet se edhe rritja e çmimit prej 5% do të rëndojë e përkeqësoi standardin jetësor edhe më shumë dhe pakënaqësia e të gjitha shtresave të varfëra po e arrijnë kulminacionin – çka është e domosdoshme për shoqërinë tonë në Kosovë si shoqëri e organizuar.

Prandaj, në emër të afro 160000 pensionistëve – të të gjitha kategorive- - Ju lusim, që edhe një herë të rishqyrtoni Vendimin në fjalë, dhe mos të lejoni rritjen e çmimit të rrymës.

Me respekt,



KRYETARI,  
Shaban Kajfazi,